



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:060150
Datë: 20.07.2023
Numri i dokumentit: 04508504

P.nr.2164/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ertan Sejfulla, bashkëpunëtorin profesional Eduart Aliu, në çështjen penale ndaj të akuzuarit L.R, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2052/23 datë 31.05.2023, për shkak të veprës penale “*Vjedhja Grabitqare*” nga neni 316 paragrafi 1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik, të mbajtur më datë 07.07.2023, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i shtetit Besart Mustafa, i akuzuari dhe mbrojtësi i të akuzuarit sipas detyrës zyrtare Av. B.SH, me datë 10.07.2023 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me 20.07.2023 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: **L.R**, nga i ati K..... dhe nëna V..... e vajzërisë Sh....., i lindur më datë, në në Republikën Federale të, me vendbanim në rrugën “.....”, objekti banesor “.....”, nr.....,, montues i xhamave, i divorcuar, baba i fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr personal, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: Me datën, rreth orës në parkingun e Q..... T....., në P....., i akuzuari L.R i zënë në befasi, duke e kryer aktin e vjedhjes me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, e ka përdorur forcën, në atë mënyrë që pasi e dëmtuara A.G ka hipur në veturën e saj, i akuzuari ka shkuar dhe e ka hapur derën e parë të pasagjerit dhe e ka marrë çantën e të dëmtuarës dhe pasi e dëmtuara nuk e ka lëshuar çantën, i akuzuari e ka tërhequr zvarrë të dëmtuarën deri jashtë dhe pasi e dëmtuara nuk e ka lëshuar çantën, i akuzuari e ka hapur çantën dhe ia ka marrë kuletën, me ngjyrë të kuqe, të markës “Salvatore Ferragamo” në vlerë 600 euro, në të cilën ka pasur 800 euro, 2 kartela bankare të bankës, 1 kartelë bankare të bankës dhe letërnjoftimin e lëshuar nga Mali i Zi, një patentë shofer të Malit të zi, letërnjoftimin

e Kosovës dhe pas largimit i akuzuari ka tentuar të bëjë tërheqje dhe pagesa nga kartelat bankare, por të cilat kanë dështuar,

- Me këto veprime ka kryer veprën penale “Vjedhje Grabitqare”, nga neni 316 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në pajtim me nenin e lartcekur dhe nenet: 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenin 242, 360, 361, 364, 365, 452 dhe 462 të KPP-së, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM DHE DËNIM ME GJOBË

- I. Të akuzuarit **L.R.**, i shqipton **Dënim me Burgim** në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim me burgim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe
- II. **Dënim me Gjobë** në shumën prej 1 (një) mijë e 200 (dyqind) Euro, të cilën dënim me gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, këtë dënim me gjobë të shqiptuar i akuzuari mund ta paguajë me tri (3) këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues dhe jo me larg se 3 muaj nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi konform nenit 43 të KPRK-së. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.
- III. Nëse i akuzuari, nuk e paguan gjobën si në pjesën e lartcekur të këtij dispozitivit të aktgjykimit, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu siç është e paraparë në nenin 43 të KPRK-së, ku njëzet (20) Euro gjobë i llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.
- IV. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 06.03.2023 deri me datë 10.07.2023 do ti llogaritet në dënimin e lartcekur me burgim ndërsa Gjykata me aktvendim të posaçëm pas shpalljes së aktgjykimit me datë 10.07.2023 ia ka ndërprerë masën e paraburgimit.
- V. **Obligohet** i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro), ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20€ (njëzetë euro). Të gjitha këto shpenzime që në total kapin shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), obligohet i akuzuari ti paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Për shpenzimet tjera eventuale gjykata do të vendos me aktvendim të posaçëm pas për-llogaritjeve të kësaj gjykate.
- VI. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2052/23 datë 31.05.2023, ndaj të akuzuarit L.R për shkak të veprës penale “Vjedhje Grabitqare”, nga neni 316 par.1 të KPRK-së.

Kompetenca e gjykatës

Gjykata para se të caktoi shqyrtimin fillestar, në vështtrimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore. Sa i përket kompetencës territoriale, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPP-së, kompetencë territoriale për të gjykuar një çështje juridiko-penale ka gjykata në territorin e së cilës është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, apo gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret vepra penale është kryer në Prishtinë, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, konsideron se me qenë se për veprën penale “Vjedhje grabitqare” nga neni 316 par.1 të KPRK-së, parashihet të dënohet me gjobë dhe me burgim tre (3) vjet deri në dhjetë (10) vjet dhe se e njëjta nuk është paraparë me nenin 22 të KPP-së, gjykata konstaton se Departamenti i Përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Shqyrtimi fillestar

Gjykata me datë 07.07.2023, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar, në të cilin shqyrtim të pranishëm kanë qenë Prokurori i Shtetit Besart Mustafa, i akuzuari L.R, me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare Av. B.SH, ndërsa e dëmtuara A.G ka munguar e njëjta e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt. Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit të akuzuarit i është dhënë mundësia të deklarohet lidhur me aktakuzën.

I akuzuari është deklaruar fajtor, ka kërkuar falje publikisht, është penduar për këtë veprë që e ka kryer, ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsëris më vepra penale, gjithashtu ka kërkuar që si rrethanë lehtësuese ti merret fakti që vullnetarisht është paraqitur në polici, është mbajtësi i vetëm i familjes, ka theksuar se nënën e ka të sëmurë rëndë, nuk ka kush të kujdeset për të pasi që ajo për momentin është e vetme prandaj e ka lutur gjykatën që ti shqiptoj një dënim nën minimumin që parashikon ligji.

Mbrojtësi i të akuzuarit sipas detyrës zyrtare ka deklaruar se pajtohet me deklarin e fajësisë të bërë nga i mbrojturi i tij, ka konsideruar se i njëjti këtë pranim fajësie e ka bërë me vullnet dhe në konsultim paraprak me të, në përputhje me dispozitat penale, nga ana e gjykatës ka kërkuar që gjatë marrjes se vendimit mbi dënimin të marrë parasysh disa rrethana lehtësuese të cilat janë dorëzimi vullnetar në polici, pranimin e fajësisë si dhe rolin kyç si bartës i familjes dhe i ka propozuar gjykatës që deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi të lirohet në liri meqë kemi ndryshim të rrethanave dhe shtonë faktin se nëna e të akuzuarit vuan nga një sëmundje e rëndë.

Prokurori i shtetit pas deklarimit nga ana e të akuzuarit për pranimin e fajësisë deklaroi pajtohet me pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit, sepse këtë pranim fajësie i akuzuari e ka bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare dhe se ky pranim fajësie ka mbështetje në prova mbi të cilat është bazuar aktakuza, gjykatës i propozon që ta aprovojë pranimin e fajësisë dhe të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit por që me rastin e matjes së dënimit të merr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Andaj pas deklarimit të akuzuarit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafi 1 të KPP. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 242 par.2 të KPP-së, lidhur me pranimin e fajësisë

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale

Gjykata ka vlerësuar elementet e kryerjes së veprës penale “*Vjedhje Grabitqare*”, nga neni 316 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në paragrafin 1 të këtij Kodi është paraparë “*Kushdo që i zënë në befasi në kryerjen e aktit të vjedhjes dhe qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, e përdorë forcën apo kanosjen serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet*”.

Nga analizimi i dispozitës së lartcekur, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret përmbushen në tërësi elementet e veprës penale “*Vjedhje Grabitqare*”, nga neni 316 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, kjo për faktin se kryesi i veprës penale gjatë marrjes së veprimeve me dashje direkte ka përdorur forcën me i qëllimit të përvetësimit të pasurisë së huaj dhe që atë pasurinë e vjedhur ta mbajë për veti, andaj me veprimet e lartcekura janë përmbushur elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur.

Vendimi i gjykatës për ta shpallur të akuzuarin fajtor

Nga deklarimi i të akuzuarit në shqyrtimin fillestar dhe nga pranimi i fajësisë u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës të ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Raporti fillestar i incidentit me nr. 2023-AD-0703 e dt.07.03.2023, deklaratat e dëshmitarëve A.G, V.S, A.C, Sh.K dhe B.Z, konfirmimet e bankës për transaksionet e dështuara, video incizimet, foto dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera që gjenden ne shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale ë cilën e ka kryer “*Vjedhje Grabitqare*”, nga neni 316 paragrafi 1 të KPRK-së,

për të cilën akuzohet i akuzuari. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi sanksionin penal

Me rastin e matjes së dënimit përkatësisht dënimit me burgim, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin e gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë, ka kërkuar falje publikisht, pendimin që ka shprehur për veprën të cilën e ka kryer, premtimin që e ka bërë se në te ardhmen nuk do të përsërisë më vepra penale, është mbajtës i vetëm i familjes ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori për bazë shkallën e lartë të dashjes gjatë ndërmarrjes se veprimeve për kryerjen e kësaj vepre penale, andaj të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në këtë rast për aplikimin e dispozitave ligjore për zbutjen e dënimit u bazua në nenin 71 paragrafi 1 në të cilin është paraparë se “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit”, nën paragrafi 1.3 parasheh se “në rast kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”, dispozita e lartcekur specifikon qartë se gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë ligjor kur i akuzuari ka pranuar fajësinë, prandaj gjykata konform me nenin 72 mbi kufijtë e zbutjes së dënimit në të cilin është paraparë se “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim:” nën paragrafi 1.3 parasheh se “nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një vit (1) vit burgim”, nga këto te lartcekurat gjykata vendosi mbi zbutjen e dënimit për të akuzuarin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale nga i akuzuari, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj vepre penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Llogaritja e kohës së kaluar nën masën e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Në nenin 79 paragrafi 1 të KPRK-së është paraparë llogaritja e paraburgimit dhe e dënimit të mëparshëm ky nen përcakton se: “Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me jobë” .

Ne mbështetje të dispozitës se lartcekur, gjykata, kohen e kaluar nën masën e paraburgimit të akuzuarit, nga data 06.03.2023 e deri me datën 10.07.2023 ia ka llogaritur në dënimin e përcaktuar me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 paragrafi 2, pikat 2.6 dhe 2.9 e lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin lidhur me shpenzimet e procedurës, duke e obliguar të njëjtin, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro), ndërsa konform nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguajë shumën prej 20€ (njëzetë euro), në emër të taksës për Programin e Kompensimin e Viktimave të Krimit, që në total kapin shumën prej 50€ (pesë dhjetë euro).

Vendimin për kërkesën pasurore juridike që pala e dëmtuar të udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.2164/23, datë 20.07.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ertan Sejfulla

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.